

Dhomat e Specializuara të Kosovës  
Marrja e Donacioneve Vullnetare të Paspesifikuara  
dhe Përdorimi i Tyre si Kontribut për Pagimin e Zhdëmtimeve  
KSC-BD-49



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

## Udhëzues Pune i Zyrës Administrative

### Marrja e Donacioneve dhe Përdorimi i Tyre si Kontribut për Pagimin e Zhdëmtimeve

Miratoi: Administratorja, Dhomat e Specializuara të Kosovës  
Data e miratimit: 28 nëntor 2024  
Data e hyrjes në fuqi: 28 nëntor 2024  
Zëvendëson: Nuk ekziston  
Numri: KSC-BD-49

PUBLIK

Faqja 1 nga 5

Versioni: 1.0

Data e versionit: 28/11/2024

**Dhomat e Specializuara të Kosovës  
Marrja e Donacioneve Vullnetare të Paspesifikuara  
dhe Përdorimi i Tyre si Kontribut për Pagimin e Zhdëmtimeve  
KSC-BD-49**

## Përmbajtja

<b>KREU I</b>	<b>DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....</b>	<b>2</b>
PJESA 1	QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI .....	2
PJESA 2	PARIMET .....	2
PJESA 3	PËRKUFIZIME.....	3
PJESA 4	ZBATIMI .....	3
PJESA 5	MBROJTJA E TË DHËNAVE .....	3
PJESA 6	VERSIONI AUTENTIK DHE HYRJA NË FUQI .....	4
<b>KREU II</b>	<b>MARRJA E DONACIONEVE DHE PËRDORIMI I TYRE PËR PAGIMIN E ZHDËMTIMEVE...4</b>	<b>4</b>
PJESA 7	MARRJA E DONACIONEVE .....	4
PJESA 8	PËRDORIMI I DONACIONEVE PËR PAGIMIN E ZHDËMTIMEVE .....	4
<b>KREU III</b>	<b>MBIKËQYRJA DHE ADMINISTRIMI.....</b>	<b>5</b>
PJESA 9	SISTEMI I KONTABILITETIT .....	5
PJESA 10	AUDITIMI .....	5
PJESA 11	SHPENZIMET.....	5

## KREU I Dispozita të përgjithshme

### Pjesa 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

- Ky Udhëzues Pune është miratuar nga Administratorja, në këshillim me Kryetaren, në përputhje me nenin 4(2), nenin 22(3), dhe nenin 34(1) dhe (3) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, (Ligji nr. 05/L-053, “Ligji”) dhe rregullën 23(8) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) me qëllim rregullimin e marrjes së donacioneve vullnetare të paspecifikuara dhe përdorimin e tyre si kontribut për pagimin e zhdëmtimeve të urdhëruara nga Dhomat e Specializuara të Kosovës (‘DHSK’).
- DHSK-ja do të krijojë një sistem për marrjen e donacioneve vullnetare të paspecifikuara për të kontribuar në pagimin e zhdëmtimeve viktimave pjesëmarrëse në proces të cilave DHSK-ja u ka akorduar zhdëmtime. Ky sistem është plotësues ndaj detyrimit parësor të personit të shpallur fajtor për pagimin e zhdëmtimit në përputhje në bazë të urdhrave për zhdëmtim dhe/ose detyrimeve të Republikës së Kosovës në këtë aspekt.
- Procesi i marrjes së donacioneve vullnetare të paspecifikuara dhe i përdorimit të tyre për pagimin e zhdëmtimeve drejtohet nga ky Udhëzues Pune dhe nga Rregullorja Financiare dhe Administrative për Marrjen e Donacioneve Vullnetare të Paspesifikuara dhe Përdorimin e Tyre për Pagimin e Zhdëmtimeve, KSC-BD-49 (‘Rregullorja Financiare dhe Administrative’).

### Pjesa 2 Parimet

- Gjatë zbatimit të këtij Udhëzuesi Pune, DHSK-ja i trajton në mënyrë të barabartë dhe të drejtë të gjitha viktimat pjesëmarrëse në proces të cilave DHSK-ja u ka akorduar zhdëmtime.

PUBLIK

**Dhomat e Specializuara të Kosovës  
Marrja e Donacioneve Vullnetare të Paspacificuara  
dhe Përdorimi i Tyre si Kontribut për Pagimin e Zhdëmtimeve  
KSC-BD-49**

- Ky Udhëzues Pune nuk liron personin e shpallur fajtor nga detyrimi parësor që ka për pagimin e zhdëmtimit, sikurse përcaktohet në urdhrin për zhdëmtim. Po ashtu, ky Udhëzues Pune nuk liron Republikën e Kosovës nga përbushja e detyrimeve të saj sipas legjislacionit vendor ose traktateve ndërkombëtare, përfshirë edhe sipas urdhrave të DHSK-së, që kanë të bëjnë me të drejtat e viktimave për zhdëmtim dhe mjete juridike efektive.
- Asgjë në këtë Udhëzues Pune nuk cenon dhe nuk është në mospërputhje me të drejtat e të akuzuarit ose të personit të shpallur fajtor sipas Ligjit dhe Rregullores.

### Pjesa 3 Përkufizime

- Në kuadër të këtij Udhëzuesi Pune, përveç nëse përcaktohet ndryshe, termat e përdorur në të kanë kuptimin e përcaktuar në Ligj dhe Rregullore dhe çdo urdhër të lëshuar nga paneli kompetent. Njëjësi përfshin shumësin dhe anasjelltas.
- Krahas kësaj, vlejné përkufizimet në vijim:

Donacion vullnetar i paspecificuar	Shumë parash që i jepet DHSK-së vullnetarisht për të kontribuar në zhdëmtimin e viktimave pjesëmarrëse të cilave DHSK-ja u ka akorduar zhdëmtim, dhe e cila nuk është caktuar për një çështje gjyqësore ose viktimë konkrete;
Autoritet gjyqësor	Një gjykatës, ose gjykatësit e caktuar nga Kryetarja, në përputhje me nenet 25 dhe 33 të Ligjit, për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimin të Urdhrit për Zhdëmtim;
Donator institucional	Qeveri ose organizatë ndërkombëtare;
Donator privat	Individë, korporata, biznese, ose subjekte të tjera (ku nuk përfshihen qeveritë ose organizatat ndërkombëtare);
Urdhër për zhdëmtim	Urdhër i formës së prerë nga një panel kompetent i lëshuar në bazë të neneve 22(8) dhe 44(6) të Ligjit, që i vë personit të shpallur fajtor detyrimin që të paguajë zhdëmtim në formë kompensimi për viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së.

### Pjesa 4 Zbatimi

Ky Udhëzues Pune interpretohet dhe zbatohet në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren.

### Pjesa 5 Mbrojtja e të dhënave

- Të gjitha të dhënat personale të mbledhura në lidhje me këtë Udhëzues Pune ruhen dhe përpunohen në përputhje me Direktivën Administrative të Dhomave të Specializuara të Kosovës për Administrimin e Aseteve të Informacionit dhe Udhëzimin Operativ për Mbrojtjen e Aseteve të

**Dhomat e Specializuara të Kosovës  
Marrja e Donacioneve Vullnetare të Paspacificuara  
dhe Përdorimi i Tyre si Kontribut për Pagimin e Zhdëmtimeve  
KSC-BD-49**

- Informacionit. Këto të dhëna u kalohen autoriteteve të tjera, përfshirë panelit kompetent, vetëm për aq sa është e nevojshme për përmbushjen e qëllimeve të ligjshme, legjitime dhe konkrete, dhe në përputhje me rregulloret e lartpërmendura. Krahas kësaj, të dhënat personale ruhen, përpunohen dhe bëhen të ditura në përputhje me urdhrat gjyqësorë përkatës për masa mbrojtëse.
2. Të dhënat personale të përmendura në paragrafin (1) mbahen aq sa zgjasin procedurat gjyqësore në DHSK dhe më pas fshihen ose asgjësohen në përputhje me afatet e DHSK-së për mbajtjen e të dhënave, përveç nëse përcaktohet ndryshe ose urdhërohet ndryshe nga paneli kompetent.

## **Pjesa 6      Versioni autentik dhe hyrja në fuqi**

1. Versioni autentik i këtij Udhëzuesi Pune është versioni në gjuhën angleze.
2. Ky Udhëzues Pune hyn në fuqi në ditën e miratimit.
3. Çdo ndryshim i këtij Udhëzuesi Pune hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

## **KREU II      Marrja e donacioneve dhe përdorimi i tyre për pagimin e zhdëmtimeve**

### **Pjesa 7      Marrja e donacioneve**

1. DHSK-ja mund të marrë donacione monetare vullnetare nga donatorë institucionalë ose privatë, në përputhje me këtë Udhëzues Pune dhe Rregulloren Financiare dhe Administrative.
2. Donacionet nuk specifikohen. Nuk pranohen donacione anonime dhe donacione me vlerë më të ulët se 100,00 euro.
3. Të gjitha donacionet janë objekt i procesit të verifikimit të duhur në pajtim me Rregulloren Financiare dhe Administrative. Donatorët duhet të japin të dhënat përkatëse, duke plotësuar Formularin për Shprehjen e Synimit për Dhënie të Donacionit Vullnetar dhe të përmbushin kushtet e procesit të verifikimit të duhur para se të japin donacione. Nëse procesi i verifikimit të duhur kryhet me sukses, donatorëve u jepet Marrëveshja e Donacionit Vullnetar dhe, pas nënshkrimit, japin donacionin sipas udhëzimeve.
4. Kërkesat për më shumë informacion në lidhje me donacionet mund të dërgohen në adresën e email-it: [info.donations.reparations@scp-ks.org](mailto:info.donations.reparations@scp-ks.org)

### **Pjesa 8      Përdorimi i donacioneve për pagimin e zhdëmtimeve**

1. Donacionet u ndahen të gjitha viktimave pjesëmarrëse në proces të cilave DSK-ja u ka akorduar zhdëmtim.
2. Pasi të gjithë urdhrat për zhdëmtim të kenë marrë formë të prerë, donacionet ndahen në përputhje me urdhrin e autoritetit gjyqësor të caktuar nga Kryetarja për këtë qëllim.
3. Donacionet u ndahen të gjitha viktimave pjesëmarrëse në të gjitha çështjet gjyqësore mbi baza proporcionale, duke marrë parasysh akordimet individuale të përcaktuara në urdhrin ose urdhrat për zhdëmtim. Shuma që i paguhet secilës viktimë pjesëmarrëse nuk e kalon shumën maksimale të kompensimit të akorduar.
4. Pagesat nga donacionet bëhen mënyrë konfidenciale dhe të sigurt.

## KREU III Mbikëqyrja dhe administrimi

### Pjesa 9 Sistemi i kontabilitetit

- Njësia e Financave dhe Buxhetit krijon një sistem kontabiliteti për të mundësuar, ndër të tjera, ndjekjen e:
  - të gjitha fondeve të derdhura në llogarinë bankare të caktuar për marrjen e donacioneve vullnetare të paspecifikuara dhe për pagimin e zhdëmtimeve ('llogaria bankare');
  - shpenzimeve të të gjitha pagesave për zhdëmtim, duke respektuar konfidencialitetin e përfituesve.

### Pjesa 10 Auditimi

- Auditori i brendshëm i DHSK-së auditon transaksionet në llogarinë bankare për të kontrolluar përputhshmërinë e tyre me këtë Udhëzues Pune, Rregulloren Financiare dhe Administrative dhe rregulla dhe procedura të tjera relevante.
- Për donacionet më të mëdha, shpenzimi për auditim të jashtëm paguhet nga donacioni, në qoftë se është e zbatueshme.

### Pjesa 11 Shpenzimet

- Të gjitha shpenzimet përkatëse mbulohen nga donacionet.
- Ndër shpenzimet që mund të mbulohen nga donacionet janë:
  - shpenzimet për mirëmbajtjen e llogarisë bankare;
  - shpenzimet për marrjen e donacioneve vullnetare;
  - shpenzimet që lidhen me tarifat bankare që zbatohen për pagimin e shumave të zhdëmtimit ose kthimin e donacioneve vullnetare;
  - shpenzimet në lidhje me auditimin e jashtëm, në qoftë se kërkohet nga donatorët;
  - normat negative të interesit që zbatohen për fondet në llogarinë bankare, nëse ka.
- Donatori njoftohet për këto shpenzime, nëse kërkohet.

Hagë, Holandë  
28 nëntor 2024

---

Dr. Fidelma Donlon  
Administratore